

Buletini i Lajmeve të Sigurisë Kibernetike

Dhjetor 2022

SIGURIA KIBERNETIKE, SOT NJË PRIORITET KOMBËTAR!



Drejtori i përgjithshëm i AKCESK Z. Igli Tafa, në vijim të takimeve me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë dhe bashkëpunimit, zhvilloi në datën 7 dhjetor, një takim me “sektorin shëndetësor, mikrofinancat dhe kompanitë e sigurimeve”.

Qëllimi i këtij takimi ishte situata aktuale e sigurisë kibernetike, mundësia e rritjes së bashkëpunimit për rritjen e sigurisë në infrastrukturat kritike, në kuadër të implementimit të strategjisë dhe vizionit të ri për sigurinë kibernetike.

Në takim u diskutua ndryshimi i kuadrit ligjor, me qëllim transpozimin e direktivave europiane të fushës, që sjell risi në krijimin e CSIRT-eve sektoriale dhe skemave të reja për certifikimin e sigurisë kibernetike për pajisjet, produktet dhe proceset TIK.

<https://cesk.gov.al/Publikime/2022/lajme.pdf>

"SIGURIA E INFORMACIONIT FINANCIAR, PRIORITET AKTUAL I AKCESK"



Në datën 21 Dhjetor, Drejtori i Përgjithshëm i AKCESK, njëkohësisht Koordinator i Kombëtar për sigurinë kibernetike Z. Igli Tafa, zhvilloi takimin me temë “Siguria e informacionit financiar, prioritet aktual i AKCESK”, me pjesëmarrës nga drejtuesit më të lartë të sigurisë në sektorët bankar dhe financiar.

Qëllimi i takimit ishte adresimi i nevojës së aplikimit të masave shtesë për mbrojtjen dhe sigurimin e informacionit financiar të qytetarëve, si fokus i Qeverisë Shqiptare dhe prioritet aktual i AKCESK.

<https://cesk.gov.al/2022/Sigura%20e%20informacionit%20financiar.pdf>

KONTAKT

Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë Albania 04-22-21039



RRITJA E AKTIVITETEVE NGA APT IRANIANE KËRKON VIGJILENCË TË SHTUAR!

Kohët e fundit është vënë re një rritje e aktivitetit nga APT Iraniane. Pas sulmeve kibernetike të zbuluara në 17 Korrik 2022, Shqipëria u bë shteti i parë në botë që ndërpret marrëdhëniet diplomatike për shkak të një sulmi kibernetik! Në atë kohë, agjencitë e specializuara brenda vendit dhe partnerët strategjikë ndërkombëtarë adresuan dhe asistuan trajtimin e sulmit të sofistikuar, të orkestruar nga aktorë të sponsorizuar nga Republika Islamike e Iranit.

<https://cesk.gov.al/Publikime/2022/Lajm%20APT.pdf>


MENAXHIMI I INCIDENTIT KIBERNETIK - PROCEDURË E DOMOSDOSHME PËR INFRASTRUKTURAT KRITIKE



Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike organizoi dy ditë rradhazi, me të gjitha Infrastrukturat Kritike të Informacionit të ndara sipas sektorëve, trajnimin e thelluar për "Menaxhimin e incidentit kibernetik", në përmbushje të objektivave të "Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025".

Qëllimi i trajnimit është në vazhden e rritjes së kapaciteteve profesionale të nevojshme për operatorët e infrastrukturave kritike në Shqipëri, si një ndër objektivat kryesore të Autoritetit. Gjithashtu, u organizua stërvitje kibernetike me skenarë të mbështetur në praktikat më të mira.

"SIGURIA KIBERNETIKE NË BALLKANIN PERËNDIMOR NË FOKUS TË SAMITIT TË BE-SË NË TIRANË"



Siguria kibernetike, trajtimi i kërcënimeve kibernetike dhe kërcënimet hibride janë fushat ku BE-ja do të thellojë më tej bashkëpunimin ndërsektorial me Ballkanin Perëndimor. Samiti konfirmoi se BE-ja është e gatshme të rritë mbështetjen e saj për qëndresën ndaj sulmeve kibernetike në Ballkanin Perëndimor dhe të intensifikojë bashkëpunimin në nivel rajonal dhe me partnerët ndërkombëtarë.

<https://cesk.gov.al/Publikime/2022/EU-WB.pdf>

Email: info@cesk.gov.al Web: www.cesk.gov.al